



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Në bazë të funksioneve dhe kompetencave që parashihen në nenin 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr.03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 për NP, Komisioni i Auditimit i KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A., vendosi të shpall këtë:

KONKURS PUBLIK Për plotësimin e një (1) pozite

1. ZYRTAR/E PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

1. Titulli i punës: ZYRTAR/E PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

Vendi: Prizren
Ndërmarrja: Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.
I përgjigjet: Komisionit të Auditimit
Niveli i pagës: Kategoria III
Mandati: 3 vite – me mundësi vazhdimi

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Kandidati/ja duhet të ketë diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS ose ekuivalente, në Ekonomi (Financa, Kontabilitet, Menaxhment) apo fusha të tjera të studimeve relevante. Diplomati nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave (*dëshmi*);
- Ekspert i certifikuar në kontabilitet apo ndonjë fushë tjetër në kuadër të financave;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në fushën e auditimit/financave ose kontabilitetit (se paku 3 vite në nivel menaxhues). Preferohen kandidatët me përvojë pune në ndërmarrjet/korporatat tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;

Procedura për aplikim:

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Aplikacioni i cili mund të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë (<https://hidroregjionijugor.com/oferte-pune/>), apo te merret kopje fizike në Kompani;
- Një C.V. e detajuar (*preferohet në shabllonin Europass*);
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës;
- Letër motivimi (*maksimum 500 fjalë*);
- Referenca (së paku dy);
- Kopje e noterizuar e diplomës mbi kualifikimin arsimor të noterizuar, ndërsa për diplomat e marra jashtë vendit të kenë nostrifikimin;
- Kopjet e certifikimeve përkatëse;
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (*nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion*);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mund të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Kompanisë ose në e-mail adresë: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen në zyrë të shërbimit për punë juridike dhe të përgjithshme në zarfë të mbyllura. Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet përveç atyre në origjinal. Konkursi do të jetë i hapur 30 (tridhjetë) ditë kalendrike nga dita e publikimit me datë 30.06.2023, e deri me datën 31.07.2023 në ora 16.00 h.

Vërejtje: Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

- Të jetë objektiv e i paanshëm;
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për NP dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave;
- Aftësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;
- Aftësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e kompanisë;
- Aftësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Ushtron funksionin në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021 dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministria e Financave;
- Vepron në përputhje me Standardet e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit dhe Kodin e Etikës;
- Harton dhe dorëzon planin strategjik dhe planin vjetor për rishikim dhe miratim të Komisioni i Auditimit;
- Bën rishqyrtimin e proceseve vendimtare të biznesit, duke vlerësuar efikasitetin e kontrollimeve të brendshme dhe duke identifikuar mundësitë e përmirësimit të mundshëm të procesit;
- Vlerëson rrezikun e proceseve kryesore të biznesit që rezultojnë me përgatitjen e planeve dhe programeve specifike të auditimit;
- Menaxhon punën e Zyrës së Auditimit;
- Monitoron dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të Aksionarit, Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit në përputhje me Planin e Biznesit të ndërmarrjes;
- Zhvillon programet e auditimit dhe pyetësorëve adekuat për verifikimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme për angazhim të ri, rishikim dhe përmirësim të programeve dhe pyetësorëve ekzistues;
- Rishqyrton dhe dokumenton rezultatet e punës së auditimit të kryer nga stafi i auditimit;
- Përgatit raporte të auditimit duke identifikuar përparësitë dhe dobësitë, përfshirë dhënien e rekomandimeve dhe konkluzioneve;
- Prezanton tek Komisioni i Auditimit raportet e auditimit për aprovim;
- Përcjell zbatimin e rekomandimeve bazuar në raportet e auditimit dhe planeve të veprimit të ndërmarrjes;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësi të cekura, kryen edhe në detyra tjera të kërkuara nga Komisioni i Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv (por që nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi);